



IOM International Organization for Migration
ONM Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

PAKETË INFORMUESE PËR SUEDINË

1. Informacioni bazë

Kryeqyteti:	Stokholm
Popullsia:	9 milion
Sipërfaqja:	450,000 km ² (174,000 mi ²)
Monedha:	1 koronë = 100 öre
Niveli i papunësisë:	6,4% (që nga janari 2008)

2. Viza për të vizituar Suedinë – Informacion i përgjithshëm

Shtetasit kroatë nuk kanë nevojë të aplikojnë për vizë për qëndrim afatshkurtër (C). Shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë i nënshtrohen kërkesës për vizë. Bazuar në Marrëveshjet për Lehtësimin e Vizave dhe Marrëveshjet e Ripranimit ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë, Bosnjë Hercegovinës, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, shtetasit e këtyre vendeve duhet akoma të kërkojnë vizë C Shengen për të hyrë në Suedi; megjithatë ata përfitojnë nga një tarifë të reduktuar për vizë (35 Euro në vend të 60 Euro). Shumë kategori të aplikantëve (familjarë të shtetasve rezidentë të ligjshëm, studentë dhe pensionistë, gazetarë etj) tani mund të marrin gjithashtu viza falas.

Për kategori të caktuara personash p.sh. tregtarë, studentë dhe gazetarë, kërkesat për dokumentacion do të thjeshtohen. Disa kategorive të personave që udhëtojnë shpesh (përfshirë këtu tregtarë, gazetarë, studentë, përfaqësuesi të shoqërisë civile) do t'u jepen viza me shumë hyrje për periudha të gjata vlefshmërie dhe mbajtësit e pasaportave diplomatike do të përjashtohen nga detyrimi për vizë.

Shihni detaje në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0085:0095:EN:PDF> (për Shqipërinë)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0097:0107:EN:PDF> (për Bosnjë Hercegovinën)

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0125:0135:EN:PDF> për ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0137:0147:EN:PDF> për Serbinë

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2007:334:0109:0119:EN:PDF> për Malin e Zi

Kjo paketë informuese u përgatit në kuadër të projektit AENEAS 2006: Rritja e Shkallës së Informimit dhe Ndërgjegjësimit për Nxitjen e Emigracionit të Rregullt në Ballkanin Perëndimor të financuar nga Bashkimi Europian dhe të bashkë-financuar nga Zyra Federale Zvicerane për Migracionin dhe Zyra Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Federal Office
for Migration
and Refugees

Për më shumë informacion për dokumentet e nevojshme dhe për procedurat, vizitoni faqen e internetit të Bordit të Migracionit në <http://www.migrationsverket.se/english.jsp> ose Ambasadën e Suedinë në vendin tuaj:

Ambasada në Shqipëri:

Konsullata Suedeze, Shqipëri
Rr. Qamil Guranjaku, Pall. 12 katesh, Shk. 2 / 5c
Tirana
Tel: +355-4-347524
E-mail: atlascoopco@icc-al.org

Ambasada në Bosnjë dhe Hercegovinë:

Ferhadija 20
71000Saravejo
Orari i punës: Nga e hëna në të premte, 9 deri në 12 paradite.
Tel: 38733276030; 38733276037 (viza)
E-mail: abassaden.sarajevo@foreignn.ministry.se
Faqja e internetit: http://www.swedenabroad.com/Start_24839.aspx

Ambasada në Kroaci:

P.P. 779
HR – 10 001 Zagreb
Adresa: Frankopanska 22
Tel: 385-(0)1-4925 100
E-mail: ambassaden.zagreb@foreign.ministry.se; swedish.embassy@zg.t-com.hr
Faqja e internetit: http://www.swedenabroad.com/Start_5854.aspx

Ambasada në Serbi:

P.O.B. 5
11040 Belgrade
Adresa: Ledi Pedzet 2
Tel: 381-11-20 69 200
E-mail: ambassaden.belgrad@foreign.ministry.se
E-mail për vizë: ambassaden.belgrad-visum@foreign.ministry.se
Orari i punës: Nga e hëna në të enjte, 8.00-17.00 (Seksioni i vizave: 9.00 – 12.00; Të mërkurën i mbyllur)
Faqja e internetit: http://www.swedenabroad.com/Page_12799.aspx.

3. Imigracioni për qëllime punësimi

Në 15 dhjetor 2008 me vendim të Parlamentit Suedez u vu në zbatim rregullorja e re e migracionit për motive punësimi.

Kjo nënkupton faktin që tregu i punës nuk ka më rendësinë e dikurshme dhe tashmë punëdhënësi është ai i cili vendos për nevojën për krah pune ndryshe nga nga më parë kur Shërbimi Suedez i Punësimit Publik vendoste për këtë. Bordi i Migracionit shqyrton nëse pagesa dhe kushte e tjera të punësimit janë në përputhje me marrveshjet kolektive ekzistuese ose me kërkesat aktuale.

Format e reja

Në baze të rregullave të reja, Bordi i Migracionit përdor format e reja të aplikimit. Ndërmjet të tjerave është një formë për oferte punësimi, të cilën duhet ta plotësojë punëdhënësi kur punëson punëtorë nga vendet e jashtë EU/EEA, të cilën punëtori duhet ta bashkëlidhi aplikimit të tij.

Lejet e punës

Për të punuar në Suedi duhet të keni leje pune. Sapo t'ju jepet një leje, kjo duhet të futet në pasaportë përpara mbërritjes në Suedi. Nëse keni ofertë për punë për një periudhë më shumë se tre muaj, atëherë nevojitet një leje qëndrimi në Suedi. Nëse planifikoni të qëndroni në Suedi më pak se tre muaj, nuk nevojitet leje qëndrimi, por vizë Shengen.

Për në Suedi ka leje të ndryshme pune- për artistët, sportistët, *au-pair*, kërkuesit vizitorë, të vetëpunësuarit, për punësim sezonal dhe gjatë pushimeve

Kërkesat:

- Forma e ofertës së punësimit në Suedi, e cila duhet plotësuar nga punëdhënësi juaj dhe duhet t'i bashkëlidhet aplikimit tuaj. Forma e re e aplikimit mund të gjendet në faqen e internetit të Bordit Suedez të Migracionit: www.migrationsverket.se/english.jsp
- Punëdhënësi juaj do të garantojë pagën, mbulimin me sigurime dhe kushte të tjera punësimit të njëjta të paktën me marrëveshjen kolektive ose praktikën suedeze në profesion ose degën e tregtisë
- Pagesa e siguruar nga punësimi duhet të jetë e mjaftueshme për të jetuar.
- Punëdhënësi juaj duhet t'i sigurojë që unionit përkatës të ketë mundësi të shprehë mendimin/opinionin e tij në lidhje me termat e punësimit.
- Punëdhënësi juaj duhet të ketë shpallur vendin e lirë të punës në Suedi dhe BE.

Nëse punësimi është i përkohshëm dhe qëndrimi dhe leja e punës do të jetë e vlefshme për atë periudhë ose për një maksimum prej dy vjetësh. Mbas 48 muajsh, ju mund të aplikoni për leje qëndrimi të përhershme.

Informacion i mëtejshëm për dokumentet e nevojshme për procesin e aplikimit për leje pune mund të merret nga faja e internetit të Ambasadës dhe në faqen e internetit të Bordit të Migracionit në: <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>

Mangësitë në tregun e punës deri në 2009

Të sapodiplomuarit	Me përvojë punë	Pritet të bien deri në 2009
Operacione, mirëmbajtje dhe HVAC	Elektricitetë	Mësues të shkollës së detyruar-studime sociale/gjuhësore
Infermier ë/e të specializuar/a të trajnuar/a	Inxhinierë ndërtimi	Kujdesi për fëmijë dhe argëtimi
Edukim për Transport	Teoria e kontrollit	Mësues të shkollës së detyruar - Matematikë/Studim e të shkencave natyrore
Telekomunikim dhe elektronikë	Operacione	Tregti dhe administrim

	mirëmbajtj e dhe HVAC	
Bujqësi dhe pyje	Industrial	Mësues të shkollave të mesme - Histori/Studime sociale

Faqet e internetit për të kërkuar punë

Nëse dëshironi të jetoni dhe të punoni në Suedi, përpara se të aplikoni për leje pune do të duhet të gjeni një punë në Suedi dhe të siguroni dokumentacionin e nevojshëm për të provuar që keni një ofertë punësimi nga një punëdhënës Suedez. Mund të konsultoni faqe të ndryshme interneti për të kërkuar punë në:

<http://www.expatsinsweden.com>,

<http://www.jobsinstockholm.com/>,

<http://www.jobinsweden.net/english/>,

<http://www.4icj.com/se/>,

<http://www.learn4good.com/jobs/language/english/list/country/sweden;>

ose faqen e internetit të Shërbimi Publik suedez të Punësimit në: <http://www.arbetsformedlingen.se/>.

4. Studime në Suedi

Nëse studimet tuaja në Suedi do të zgjasin më shumë se tre muaj, duhet të merrni një leje qëndrimi përpara se të mbërrini në Suedi. Lejet jepen nga Bordi Suedez i Migracionit. Faqet e tyre të internetit përmbajnë këshilla të detajuara në <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>.

Për informacion specifik për të studiuar në Suedi konsultoni faqen e internetit:

http://www.studyin.sweden.se/templates/cs/SISFrontPage___4908.aspx.

Aktualisht ka shumë programe që ofrohen në gjuhën angleze në universitetet suedeze. Ato mund të shikohen në: http://www.studyinsweden.se/templates/cs/SISProgramSearch___5046.aspx.

Ka shumë mënyra sesi mund të gjeni financim për t'ju ndihmuar që të përballoni qëndrimin tuaj: bursa, punë, etj. Nëse keni leje qëndrimi, nuk ju duhet leje pune për të punuar në Suedi gjatë studimeve.

Instituti suedez, një agjenci qeveritare, çdo vit administron mbi 500 bursa për studentët dhe kërkuesit që vijnë në Suedi dhe janë kryesisht për studime në nivel Masteri ose studime/kërkime të avancuara. Mund të gjeni listën e bursave të disponueshme për Suedinë në: http://www.studyin.sweden.se/templates/cs/Article___10499.aspx.

Më interes për shtetasit e Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zit dhe Serbisë është Programi Master për Europën Lindore:

http://www.studyinsweden.se/templates/cs/Article___15719.aspx

Aplikantë nga të gjitha vendet e lartpërmendura mund të aplikojnë për studime të nivelit Master në demokraci (përfshirë çështjet gjinore), ekonomi, studime mjedisore dhe energji.

Përveç këtyre më lart, ka fusha të tjera studimi që janë të hapura për kandidatë nga disa vende si më poshtë:

Aplikantë nga Shqipëria janë të pranueshëm për kurse në fushën e shkencave të shëndetit dhe çështjeve sociale.

Aplikantë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia janë të pranueshëm për kurse në fushën e shkencave bujqësore.

Aplikantë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Maqedonia janë të pranueshëm për kurse në fushën e pyjeve.

Në 150 universitetet kryesore europiane, ka tetë universitete nga Suedia në 2007:

- Universiteti i Uppsalas: <http://www.uu.se/en/>
- Universiteti i Lund-it <http://www.lu.se/lund-university/>
- KTH, Instituti Mbretëror i Teknologjisë http://www.kth.se/?l=en_UK
- Universiteti i Teknologjisë Chalmers, <http://www.chalmers.se/en/>
- Universiteti i Stokholmit <http://www.su.se/pub/jsp/polopoly.jsp?d=3792>
- Shkolla Ekonomike e Stokholmit <http://www.hhs.se/default.htm>
- Universiteti Göteborg <http://www.gu.se/english/>
- Universiteti Umeå http://www.umu.se/umu/index_eng.html

5. Qëndrimi

Nëse një person planifikojë të qëndrojë në Suedi për një periudhë më shumë se tre muaj, atëherë një leje qëndrimi suedeze është e nevojshme. Bordi suedez i Migracionit vendos për dhënien e lejes së qëndrimit. Zakonisht, një person mund të marrë leje qëndrimi ndërmjet 6 muaj dhe një leje qëndrimi të përhershëm (të pakufizuar). Nëse një person është në moshë për të punuar, merret automatikisht një leje pune.

Duhet të paraqisni: (i) një formular aplikimi dhe (ii) dy fotografi për ambasadën suedeze në vendin tuaj, që do të bashkëpunojnë me Bordin suedez të Migracionit që të merret një vendim.

Kushtet për të aplikuar

- Nëse jeni i martuar, bashkëjetoni apo synoni të martoheni ose të bashkëjetoni me dikë që është rezident i përhershëm në Suedi (sapo të keni dorëzuar aplikimin, do të thirreni për intervistë në Ambasadë/Konsullatë. Duhet të sillni një dokument që vërteton marrëdhënien tuaj me personin në Suedi, si për shembull letra, fotografi ose certifikatë martesë)
- Nëse jeni nën 18 vjeç, i pamartuar dhe prindërit tuaj janë rezidentë në Suedi (duhet të jeni në gjendje të tregoni që keni jetuar së bashku në vendin tuaj të origjinës/qëndrimit përpara ardhjes së prindit ose prindërve tuaj në Suedi)
- Nëse jeni prind ose i afërm i ngushtë i një personi që tani është rezident në Suedi (në raste të jashtëzakonshme, të afërm të tjerë mund të kualifikohen për leje qëndrimi për arsye të lidhjeve familjare. Duhet të vërtetoni që keni jetuar me të afërmin tuaj menjëherë përpara zhvendosjes së tij/saj në Suedi dhe që jeni në ngarkim të atij personi në mënyrë të tillë që e bën të vështirë të jetoni të ndarë. Kjo do të thotë që duhet të jeni të varur financiarisht, shoqërisht ose emocionalisht nga i afërmi që jeton në Suedi)
- Të afërmit të një refugjati ose një personi të cilit i është dhënë azili për disa arsye të tjera në raste të jashtëzakonshme mund t'i jepet leje qëndrimi në Suedi nëse të dy kanë pasur marrëdhënie të ngushtë, edhe nëse nuk kanë jetuar bashkë të vendin e mëparshëm të qëndrimit.

Sa kohë është e vlefshme leja?

Nëse keni jetuar bashkë me të afërmin tuaj në vendin tuaj të origjinës/qëndrimit, Bordi i Migracionit normalisht do t'ju japë një leje qëndrimi të përhershëm (PUT) Kjo ju jep të drejtën të jetoni në Suedi sa kohë të doni. Nëse nuk keni jetuar me të afërmin tuaj në vendin tuaj të origjinës/qëndrimit, por synoni të krijoni një familje së bashku pas mbërritjes tuaj këtu, Bordi i Migracionit normalisht do t'ju japë një leje për 12 muaj (në disa raste për gjatë muaj).

Pastaj do t'ju duhet të aplikoni për një shtyrje të lejes. Nëse akoma jetoni bashkë, leja juaj do të shtyhet më tej për 12 muaj (ose gjashtë muaj).

Nëse jeni në moshë madhore, do t'ju jepet gjithashtu automatikisht leje pune.

Nëse keni pasur leje qëndrimi të kufizuar për dy vjet dhe marrëdhënia juaj është akoma e paprekur, do t'ju jepet leje qëndrimi të përkohshëm.

Informacion i mëtejshëm për dokumentacionin e nevojshëm për procesin e aplikimit për leje pune mund të merret nga faqja e internetit të ambasadës ose nga faqja e internetit të Bordit të Migracionit në <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>.

Sistemi i kuotave/marrëveshje dypalëshe punësimi

N/A

6. Azilkërkues dhe refugjatë

Bordi i Migracionit shqyrton aplikime nga azilkërkues që kanë arritur deri në Suedi, u ofron azilkërkuesve akomodim të përkohshëm, drejton qendrat e ndalimit ku njerëzit e ndaluar mbahen pas dyerve të mbyllura (vetëm në raste të veçanta dikush mund të ndalohej). Suedia është shtet palë i Konventës së OKB-së për Refugjatët dhe si i tillë, duhet t'u japë azil personave që Konventa i përkufizon refugjatë. Sipas legjislacionit suedez, persona që nuk janë refugjatë sipas Konventës mund të kualifikohen gjithashtu për azil, të përshkruar në legjislacion si "persona që kanë nevojë për mbrojtje" (*skyddsbehövande*).¹ Sapo të jetë e mundur, pas dorëzimit të aplikimit nga azilkërkuesit, Bordi i Migracionit shqyrton nëse arsyet për aplikimin e tyre janë të duhura. Nëse Bordi gjykon që aplikimi i azilkërkuesit mund të refuzohet, sigurohet që atij ose asaj t'i jepet ndihmë ligjore në formën e këshillimit publik. Këto këshillimeve paguhen nga Bordi i Migracionit për të ndihmuar që azilkërkuesit të paraqesin arsyet e tyre për azil. Bordi i Migracionit shqyrton çdo rast në mënyrë individuale dhe koha që duhet për të marrë një vendim varet nga faktorë të tillë si numri i azilkërkuesve që kanë mbërritur në muajt e fundit dhe kompleksiteti i çështjeve të tyre. Atyre të cilëve u miratohet aplikimi për azil, ose nga Bordi i Migracionit ose nga Gjykata e Migracionit, normalisht u jepet një leje qëndrimi të përhershëm (PUT). Kjo do të thotë që keni të drejtë të qëndroni në Suedi një herë e përgjithmonë. Nëse aplikimi juaj për të përfutur azil nuk aprovohet dhe vendimi ka hyrë në fuqi ju mund të aplikoni për leje pune dhe qëndrimi në Suedi.

Një leje mund të përfitohet nëse ju keni qenë i punësuar për gjashtë muaj gjatë periudhës së pritjes dhe punësimi do të zgjasë dhe për 12 muaj të tjerë mbas ditës së aplikimit. Ju duhet të dorëzoni aplikimin në Bordin e Migracionit brenda dy javëve pas dates së shpalljes së vendimit.

Për më shumë informacion për azilin, shihni: <http://www.migrationsverket.se/english.html>.

7. Bashkimi familjar

Nëse dëshironi të shkoni në Suedi të jetoni me një të afërm të ngushtë që është tashmë rezident suedez, duhet të keni një leje qëndrimi tuajën. Kjo vlen për shembull, nëse jeni i martuar, ose bashkëjetoni, ose synoni të martoheni apo bashkëjetoni me dikë që është rezident i përhershëm në Suedi, dhe për fëmijët e pamartuar nën 18 vjeç (shihni "kushtet për të aplikuar" në Seksionin 5 më lart). Për formularë të

¹ Personat që kanë nevojë për mbrojtje dhe ata që kanë ikur nga vendi i tyre amë dhe kanë arsye të forta për të pasur frikë nga ndëshkimi me vdekje, tortura, etj dhe që kanë nevojë për mbrojtje për shkak të konfliktit të armatosur të brendshëm ose të jashtëm ose të një katastrofe mjedisore në vendin e tyre të origjinës. Personat që mund të tregojnë që ekzistojnë rrethana jashtëzakonisht stresuese mund të fitojnë lejen për të qëndruar në Suedi gjithashtu. Kjo vlen për shembull për ata që vuajnë nga një sëmundje e rëndë për të cilën nuk ka mundësi trajtimi në vendin e tyre. Si rregull, një personi të cilit i jepet azil në Suedi i jepet një leje qëndrimi të përhershëm (PUT) që do të thotë që ai ose ajo mund të qëndrojë përgjithmonë këtu. Në mënyrë alternative, në rrethana të caktuara, Suedia mund të jetë një leje të përkohshme me afat të caktuar.

nevojshëm dhe informacion të mëtejshëm për kërkesa specifike, konsultoni faqen e internetit të Bordit Suedez të Migracionit në <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>, dhe/ose faqen e internetit të Ambasadës Suedeze në vendin tuaj.

8. Sistemi i kujdesit shëndetësor

Sistemi suedez i kujdesit shëndetësor ndahet ndërmjet shtetit, këshillave të konteve dhe bashkive. Shteti është përgjegjës për sistemin shëndetësor në përgjithësi dhe për politikën e kujdesit mjekësor. Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies si një autoritet mbikëqyrës merret me çështje të shërbimeve shëndetësore dhe sociale që lidhen me imigrantët dhe refugjatët. Bordi ndjek sesi këshillat e konteve sigurojnë kujdes për azilkërkuarit. Më shumë informacion mund të merret në faqen e internetit të Bordit Kombëtar të Shëndetit dhe Mirëqenies në:

<http://www.socialstyrelsen.se/en/Subjects/Immigrants+and+refugees/>

9. Sistemi i sigurimeve shoqërore

Roli i Agjencisë suedeze të Sigurimeve Shoqërore është të administrojë sigurimet shoqërore dhe të sigurojë që të merrni përfitimet dhe ndihmat për të cilat keni të drejta. Më shumë informacion mund të gjendet në <http://www.forsakringskassan.se/sprak/eng/>. Akti për Shërbimet Sociale mund të gjendet në: http://www.socialstyrelsen.se/NR/rdonlyres/09C25501-F370-409A-AF2F-7910FF6FB9D1/8030/20021149_rev.pdf.

10. Strehimi

Informacion i plotë për faqet e internetit për strehimin në Suedi mund të gjendet në: <http://www.thelocal.se/6428/20070216/>. Shënim: shumica e këtyre faqeve janë në suedisht. Nuk ka kushte të veçanta për migrantët.

11. Njohja e diplomave të huaja

Nëse jetoni në Suedi dhe kërkon punë, mund t'ju hyjë në punë një njohje formale me shkrim e diplomave të huaja. Arsimimi dhe pranueshmëria juaj vlerësohen në mënyrë të veçantë nga universiteti ose kolegji ku aplikoni në bazë të informacionit të dhënë në aplikimin tuaj dhe dokumenteve të bashkëngjitura. Nëse këto të fundit nuk janë në anglisht, do të kërkojnë përkthimet e noterizuara. Disa universitete dhe kolegje universitare mund të pranojnë dokumente gjithashtu në gjuhë të tjera kryesore europiane.

Njohja zyrtare e diplomave të huaja parauniversitare bëhet nga Zyra Kombëtare e Pranimeve për Arsimin e Lartë. Shihni faqen e internetit në: <http://www.vhs.se/templates/Page.aspx?id=467>.

Njohja zyrtare e diplomave të përgjithshme akademike bëhet nga Qendra Kombëtare Suedeze e Informacionit për Njohje Akademike (NARICS), një seksion i Agjencisë Kombëtare për Arsimin e Lartë. Agjencia është gjithashtu pika e parë e kontaktit për direktiva të përgjithshme të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale në BE. Për më shumë informacion, shihni: <http://www.hsv.se/2.539a949110f3d5914ec800056285.html>.

12. Shërbime mbështetëse për Migrantët

Çështje të rëndësishme:

Ombudsman i Aplikantit- nëse aplikantët nuk janë të kënaqur me punën e Bordit të Migracionit mund të kontaktojnë me Ombudsman të Aplikantit. Për më shumë informacion: <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>.

Instituti i Imigrantëve, a organizatë joqeveritare që funksionon si qendër kombëtare kërkimi dhe dokumentacioni për imigrantë dhe refugjatë, dhe një sekretariat për organizata të tjera për imigrantë: <http://www.immi.se/insti/english.htm>.

Bashkimi Kombëtar i Grave Imigrante: <http://www.riffi.org/>

Terrafem ka një linjë ndihme kombëtare për gratë imigrante të të gjitha moshave. Nëpërmjet kësaj linje ofrohet mbështetje në 35 gjuhë: <http://www.terrafem.org/>

Çështje të dhunës gjinore:

Shoqata suedeze e strehëve të grave: <http://www.kvinnojour.com/hjalpfinns/sprak///>

Elektra ofron mbështetje në disa gjuhë për vajzat e reja: <http://www.elektra.nu/index2.htm>.

Forum – Gratë dhe Paaftësitë, për të siguruar që të gjitha gratë dhe vajzat me paaftësi të realizojnë të drejtat e tyre: <http://www.kvinnor-handikapp.se/home/page.asp?sid=680&mid=2&CatId=3174>.

Gruaja Mund, organizatë që merret me promovimin e të drejtave të barabarta të grave: http://www.kvinnorkan.se/index.php?option=com_content&task=view&id=18&Itemid=15.

Bashkimi Kombëtar i Strehëve të Grave dhe Vajzave, rrjet kombëtar për strehët e grave dhe vajzave në Suedi: http://www.roks.se/languages/english_about.htm.

Trafikimi:

Grupimi i Grave Suedeze – ndihmon viktimat e trafikimit: <http://www.sverigeskvinnolobby.se/home/page.asp?sid=2357&mid=2&PageId=18856>

Fondacioni OJQ suedez për të drejtat e njeriut: <http://www.humanrights.se/>

Çështje të përgjithshme për migrantët:

Porta për në sektorin publik në Suedi, në anglisht dhe serbisht: <http://www.sverige.se/>

Qendra për Kërkim Shumetnik: http://www.multietn.uu.se/index_eng.htm

Qendra Kërkimore për Migracionin Ndërkombëtar dhe Marrëdhëniet Etnike: <http://www.ceifo.su.se/pub/jsp/polopoly.jsp?d=6667&a=24835>

Çështje të diskriminimit dhe shkeljes së të drejtave të njeriut të migrantëve

Ombudsman i Parlamentit– merret me individë që ankohen për trajtim të padrejtë të nëpunësve publikë: <http://www.jo.se/Page.aspx>

Ombudsman për Diskriminim Etnik: <http://www.do.se/>

E-mail: do@do.se

Ombudsman për Mundësitë e Barabarta – merret me mundësitë e barabarta dhe diskriminimin seksual <http://www.jamombud.se/>

Zyra e Ombudsman-it kundër Diskriminimit për arsye të Orientimit Seksual <http://www.homo.se/o.o.i.s/1211>

Shoqata e migrantëve serbë në Suedi: <http://www.srpstvo.com/ser/vesti/index.php>.

Shoqata e migrantëve boshnjakë në Suedi (*Bosnisk Hercegovinska Ungdomsforbundet*): <http://www.bhuf.org>

Kurse gjuhe

Kurset falas të gjuhës suedeze ofrohen vetëm për azilkërkuesit. Megjithatë, ka disa shoqata studimi në vend që ofrojnë kurse të gjuhës suedeze për të gjitha grupet. Mund të pranoheni për kurse universitare në Suedisht ose me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme. Sapo të keni arritur një nivel të caktuar zotërimi, mund ta vërtetoni këtë me teste të njohura.

Zyra e IOM-it në Suedi

Në Suedi nuk ka zyrë të IOM-it. IOM Helsinki merret me kërkesa për kthim vullnetar të migrantëve të parregullt dhe shërbime të tjera të migracionit në Suedi. IOM Helsinki siguron shërbime për kthim vullnetar për të gjitha vende në botë nga Suedia.

Linja e IOM-it për informacion të përgjithshëm: +358 9 684 1150

Orari i punës: Nga e hëna në të premte 9:00-11:30 dhe 12:00-15:00 (me orën suedeze)

13. Shtetësia

Bordi Suedez i Migracionit trajton çështje të shtetësisë suedeze.

Shtetësia suedeze mund të fitohet nëpërmjet procedurës së thjeshtë (njoftimit) nëse bazohet në lindje, adoptim (nëse një prind është suedez), ose legjitimim (martesë e prindërve). Një tjetër parim bazë është parandalimi i situatës së mospasjes së shtetësisë.

Shtetësia suedeze për migrantët mund të fitohet edhe me aplikim, (natyralizim), nëse një person ka leje qëndrimi të përhershëm, nëse ai/ajo ka qëndruar në Suedi për pesë ose më shumë vjet, ose katër vjet (nëse ai/ajo ka statusin e refugjatit ose është person pa shtetësi).

Parimi i parë për të parandaluar situatën e shtetësisë së dyfishtë është braktisur dhe ligji e pranon plotësisht shtetësinë e dyfishtë. Akti suedez i shtetësisë nga 2001 mund të gjendet në:

<http://www.sweden.gov.se/content/1/c6/01/94/49/a6b33bc0.pdf>.

Për më shumë informacion për aplikimin për shtetësi shihni faqen e internetit të Bordit Suedez të Emigracionit në: <http://www.migrationsverket.se/english.jsp>

14. Institucionet qeveritare përgjegjëse për imigracionin

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për politikat e Suedisë, që përfshijnë pritjen e azilkërkuesve dhe imigrantëve, duke siguruar strehë për refugjatët, çështje që lidhje me të drejta, detyrime dhe mundësi të barabarta për të gjithë. Për më shumë informacion për këto çështje shihni faqen e internetit të Qeverisë së Suedisë: <http://www.sweden.gov.se/sb/d/3083>, dhe faqen e internetit të Ministrisë së Drejtësisë në: <http://www.sweden.gov.se/sb/d/584>.

Ministria e Integritimit dhe Barazisë Gjinore menaxhon politikat e integritimit që përfshijnë çështje të të drejtave, detyrimeve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, prezantimin e imigrantëve në shoqërinë suedeze, shtetësinë suedeze dhe grantet për bashkitë në lidhje me pritjen e refugjatëve dhe masat për të luftuar diskriminimin, ksenofobinë dhe racizmin. Më shumë informacion dhe akte ligjore në lidhje me këto çështje mund të gjenden në: <http://www.sweden.gov.se/sb/d/2188/a/19443>.

Bordi Suedez i Migracionit

<http://www.migrationsverket.se/english.jsp>